

Diskutim publik “Mati”

data:09.06.2022 ora:16:00

Vendi: SHFMU “Mitrush Kuteli” Përmbajtja:

- 1.Regjistrimi i pjesëmarrësve;
- 2.Qëllimi i takimit;
- 3.Prezentimi i vizionit;
- 4.Prezentimi i objektivave;
- 5.Diskutim me qytetarët për Planin Zhvillimor dhe Hartën Zonale;

Pjesëmarrës në takim:

- 1.Perparim Rama, Kryetar i Komunës;
2. Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës;
3. Mimoza Sylejmani, drejtore në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik
- 4.Arber Sadiki, drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit

Regjistrimi i pjesëmarrësve

(te bashkëlidhura i gjeni listat e nënshkrimeve)

PROCESVERBAL

Nga takimi me qytetarë në lagjen “Mati”

Arbër Sadiki, drejtor. Përshëndetje të gjithëve, jemi në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe hartimit të Hartës Zonale për Komunën e Prishtinës. Ju e dini që Harta Zonale është një dokument planor që për herë të parë po bëhet edhe pse e shih Ligji për planifikim prej vitit 2013. Kusht për me e hartuar një Hartë Zonale është fillimisht të aprovohet Plani Zhvillimor Komunal i riu.

Jemi në proces, edhe Ligji për planifikim e parasheh disa manuale që janë zhvilluar me USAID-in, e mbështesin, që plani zhvillimor dhe Harta zonale me u zhvilluar në të njëjtën kohë, sepse njëra- tjetrën pak a shumë e plotësojnë. Jemi këtu me juve jo vetëm pse e parasheh ligji, por jemi këtu sepse mendojmë që diskutimi publik nuk është vetëm çështje protokollare, por është çështje përmbajtjesore. Sot po e fillojmë dhe mendojmë me ardhur edhe shumë herë të tjera deri në përpilimin e këtij drafti, me diskutuar realisht për problemet që ekzistojnë dhe me i diskutuar bashkë mundësitë se si mundemi me i zgjidh ato. Edhe në takimet e mëparshme kemi pasur ndoshta ankesa, sepse s’kemi ardhur me një propozim. Ne mendojmë që pikërisht gabimet janë bërë, që hapi i parë i diskutimit ka qenë me propozimet që kanë ardhur prej vet Komunës.

Planet e mira behën kur baza, problematikat të gjitha ato çështje që duhet të trajtohen duhet të vijnë fillimisht prej diskutimeve me publikun, për atë ndihuni të lirë për çka do që ju mendoni se ne duhet me e ditë në këtë proces të bërjes së këtyre dokumenteve. Zona e juaj e dini edhe ju vet se çfarë problematikash ka, ndoshta jo veç për shkak të planit që ka ekzistuar, por me shumë për, shkak të mënyrës se si është, implementuar që ja këtu p.sh.(tregon hartën) “Mati 1”, e precizon saktë që çdo bllok urbanistik me u zhvillu në tersi. Kjo nuk ka ndodhë dhe ka filluar me u zhvillu në mënyre pjesore dhe ky zhvillim mandej e ka krijuar këtë kualitet të cilin në e kemi momentalisht në Mat.

Shumicën e rasteve janë dhënë leje ndërtimore duke marrë parasysh edhe rrugën e planifikuar dhe rrugën ekzistuese, edhe tani kjo pjesë vlon nga rrugët, sepse duke u zhvilluar pjesërisht është dashtë me lënë funksionale edhe rrugën që është në terren e që është dashtë me u mbyll në momentin që kryhet blloku edhe ne anën tjetër është dashtë me lënë sipërfaqe edhe për rrugën e planifikuar, dhe kjo mandej e ka zvogëluar hapësirën për gjelbërim e për gjithçka. Nuk kisha vazhduar me shumë se ju veç i dini këto, sot ne kemi ardhur më shumë me dëgjuar, e në takimet e radhës ne do të vijmë me letra me harta të shtypura me mundësi që me e diskutuar secilën pjesë, konkretisht dhe cilët kanë me qenë skenarët e zhvillimit.

Behar Selmani, banor i lagjes, arkitekt. Përshëndetje të gjithëve, në këtë rast unë prezantoj jo vetëm pronën time ku banoj në “Matin 2”, por i përfaqësoj edhe pronat e një sipërfaqe prej 5 ha. Deri tani ne kemi qenë të diskriminuar duke na lënë me një koeficient shumë të ultë. Me një vendim të ish-kryetarit Shpend Ahmeti, pjesa e “Matit 2”, është lënë me koeficient 1.2 e deri të ky përrua (tregon në hartë) që e ndan kufirin me “Matin 1” dhe “Matin 2”, ndërsa koeficienti sipas planit rregullativ në “Matin 1”, është 2.4.

Ne të gjitha takimet që i kemi pasur me zyrtarët e Drejtorisë siç Urbanizmit na është thënë arsyetimi se nuk duan me i ndërpre vizurat që janë drejtë Zllatarit, ama për ironi si të dalim në rrugën kryesore ato vizura i prishë “Marigona Hill”, me ndërtesat e larta që kanë filluar me u ndërtuar, andaj ne banorët e “Matit 2”, kërkojmë që të rishqyrtohet, dhe të behët rritja e këtij koeficienti, sepse ekziston infrastruktura, ekziston edhe infrastruktura sociale, duke përfshirë shkollat, çerdhe mandej edhe qendra të mjekësisë familjare dhe urojme që do të dëgjohet zëri ynë edhe nuk do të bëhen gabime siç janë bërë nga udhëheqësit paraprak, faleminderit.

Ismet Haziri, banor i lagjes, sekretar i bashkësisë lokale VII/2. Unë po i paraqes kërkesat e banorëve, kemi të bëjmë më shumë me banorët e Zllatarit dhe Matiqanit. Unë si sekretar kam përgatitur me shkrim qëndrimet tona, problemet që i ka bashkësia e VII/2 lokale janë evidente nga vetë fakti se ka një shtrirje të gjerë me numër të madh të banorëve, me shtrirje të shumta infrastrukturore, e të kërkesave të mëdha sociale e shoqërore.

Kemi rrugë të ngushta me kapacitete të vogla, kanalizimi dhe pa kanalizim fare, furnizim të dobët me ujë të pijshëm dhe pa ujë fare, transport jo të mirë publik që është Zllatari, mungesë të shkollave që është “Mati 1”, mungesë të çerdheve. Po fillojë më Zllatar, pas shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit mbetëm pa rrugë, fatmirësisht jemi në proces të ndërtimit të rrugës dhe shtimit të rrjetit të ujësjellësit, por duhet të përmend bujarinë e pronarëve të tokave, nga restorant “Panorama”, deri te restorant “Kulla e Shqiponjave”, të cilët e kanë dhënë tokën e vet pa kurrfarë kompensimi.

E kemi edhe një problem me legalizimin e varrezave dhe mirëmbajtjen e tyre. Kemi një kërkesë nga banorët me një çezme që quhet çezma e Zllatarit, që të kthehet në funksion, të sistemohet gjelbërimi

dhe të kthehet rekreacioni, pushimi në atë zonë. Kemi problemin e gjerësisë së rrugës nga shkolla ku jemi tani, deri të "Panorama", që është vetëm 5.5 metra që pengon qarkullimin e automjeteve me tonazhe të larta.

Nafije Gashi, jam këtu si përfaqësuese e Këshillit të prindërve të shkollës "Iliria". Para 1 muaji ka ndodh një aksident ku është lënduar një fëmijë, e kemi një kërkesë për kryetarin, që të bëhet sinjalizimi rreth shkollës, mundësisht ndalimin e parkingjeve rreth shkollës dhe vendosja e rrethojës. Gjithashtu shkolla ka qenë në program për renovim dhe që 10 vite nuk ka as edhe një investim në shkollën tonë. Një problem shumë i madh për fëmijët që e frekuentojnë shkollën tonë është edhe linja 4 e autobusit e cila kalon në një pikë shumë të ngushtë me shkollën, e shpeshherë nuk mundë të kthehet dhe kjo e shkakton aksidentin.

Pothuajse çdo muaj autobusi i linjës 4 të shkollës "Iliria", e ka nga një aksident, ju kisha lutur juve që rrugën B, të vazhdoni të rrethi të xhamia, aty janë vetëm 800 metra pa shpronësuar dhe kishte me e

liruar një fyt të ngushtë që bëhet rreth shkollës për të gjithë banorët kishte me qenë një akses shumë i mirë, ju faleminderit.

Naile Gashi, stomatologe. Po i dëgjoj me vëmendje diskutimet, arkitekti në fjalë doli dhe foli më herët për punën e koeficienteve që me u ngrit në "Matin 2", dhe unë jam banore e "Matit 2", dhe ne nuk jemi të pajtimit me u ngrit. Tek ne është e lejuar 1.2, jemi të mendimit që të vazhdohet me at koeficient, janë lagje të banueshme me shtëpia private, ne jemi popull që kemi ikur prej qytetit prej tollovisë prej ndërtimeve të larta e me ardhur e me u ngulfat këtu prapë nuk po me duket e drejtë.

Edhe një shqetësim tjetër e kam, lagjja që është në ndërtim e sipër që është kodra, që lidhet me "Sofalinë", e ka dëmtuar shumë, dheun që e kanë shkarkuar aty të kodra dhe e kanë bërë një farë ndotje, dhjetëra herë inspektorati është lajmëruar dhe kanë lejuar një veprim të tillë, çka mua me intereson mos është qëllim apo projekti i Komunës, që kodra me vazhduar me u dëmtuar deri në atë masë, duke e ditur që ato janë mushkëritë e Prishtinës.

Lumnije Gashi, arkitekte. Koeficienti të mos mbetet dëshirë e qytetareve, ta trajtoni profesionalisht çështjen e koeficientit. Kamë disa kërkesa, këto kërkesat i kamë dorëzuar edhe me shkrim në formë peticioni qeverisjes së mëparshme, po i paraqes edhe këtu.

1) Të bëhet ndriçimi publik në rrugën "Mitrush Kuteli", se po kemi problem mandej edhe me qentë endacak.

2) Rregullimi i ndalesave të autobusit, stacioneve.

3) Të kemi gjelbërim përgjatë rrugës, në pjesët ku mundet me u bërë.

Naser Gashi, për vazhdimin e rrugës B, është rrugë jetësore për Matin dhe një pjesë të Prishtinës, e kam edhe një porosi prej banorëve të Butovcit, që të caktoni një datë, për një takim kur të doni ju.

Faleminderit për mënyrën se si po punoni, që po i merrni në konsideratë kërkesat e qytetarëve, ju faleminderit.

Nexhat Hapaj, banor në rrugën "Zara". Kamë aplikuar për legalizim të pronës, e kam paguar taksen, urbanizmi e ka lëshuar certifikatën e legalizimit, mirëpo kadastra nuk ka ditë me e regjistruar një pjesë të terracës të shfrytëzueshme. Që 2 vite nuk ka asgjë, kam qenë në Ministri të Ambientit, kam qenë në urbanizëm, që sipas atyre çdo gjë është në rregull, tash me ka ardhur një letër që thotë që duhet me i shënuar linjat, që nuk kalojnë në pronën time, shihet edhe në fotografi, dhe me kanë thënë me e hekë

terracën, e kam një afat kohor 60 ditor. Kam shkruar shumë emaila, kamë kërkuar shumë herë takime, nuk është zgjidhur ky problem. A e ka Komuna në plan me i rregulluar këto çështje të terracave të shfrytëzueshme.

Kadrush Latifi, jam përfaqësues i banorëve kompleksi "ARKOS", te shkolla "Mileniumi". Kompleksi "ARKOS" është i pajisur me leje ndërtimore dhe me pranim teknik. Parcela ku është ndërtuar kompleksi ka qenë diku 78 ar, ndërsa 34 ar janë pajisur me leje ndërtimore, ndërsa 43 ar kanë mbetur jashtë parcelës ndërtimore. Banorët që disa herë kanë dalë dhe e kanë thurur atë pjesën e mbetur jashtë parcelës ndërtimore. Më plan rregullativ thuhet që ajo pjesë me leje dhe kushte ndërtimore i takon infrastrukturës, ose pjesës së rrugëve.

Ne kemi bërë kërkesë pranë Drejtorisë së Urbanizmit, drejtori i urbanizimit bashkë me banorët kanë pasur një takim, ku pronarët kanë thënë që nëse shpronësohet parcela jashtë tokës ndërtimore, ne do të bllokojmë përsëri dhe vazhdohet vazhdimisht. Edhe pjesa rreth ndërtesës ka mbetur si ishull dhe është e bllokuar prej banorëve. Ju kisha lutë që pasi në përgjigjen prej drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit që kjo pjesë i takon Drejtorisë së Pronës për shpronësim, është shumë e vërtetë, por ju kisha lutë që urgjentisht të zgjidhni këtë çështje, që ne të mos kemi probleme.

Fatmir Azemi, unë kisha pas dëshirë me ju pyet të gjithëve këtu cila lagje i plotëson kushtet e banimit, këtu, asnjë, ku me jetuar secili kërkesat në veti, unë kamë një kërkesë që të ndërtohet por ti kemi kushtet elementare për një jetë të shëndetshme, jo vetëm koeficient, por vlera, në Prishtinë nuk ke ku me jetuar.

NehatTolaj, unë jetoj në rrugën "Loshi", të përroi i vogël afër lagjes që po ndërtohet "Kodrina", kanalizimet aty të gjitha janë në sipërfaqe, kundërmojnë tërë kohës, një gropë që e kanë hapur ata që po ndërtojnë, është e pamundur jetesa për ne që i kemi shtëpitë aty. Tani po flas si kryetar i Këshillit të shkollës, lagjja "Matiqan", nuk e ka as edhe një vend ku fëmijët tanë mundën me luajt, është një sallë e mbyllur që përdoret nga nxënësit kur janë në shkollë, është edhe një fushë jashtë, edhe rreth asaj fushe ka hapësirë të Komunës që mundet me u kthyer në park e pjesë me lodra për fëmijë. Për ne që jetojmë në "Matiqan", rrugët i shfrytëzojmë për me ec edhe për me luajtur, pra ju kisha lutë që ta bëni një zgjidhje që edhe fëmijët tanë të kenë një pjesë ku mund të argëtohen.

Halil Gashi, në pjesën ku jemi ne 500 m 1 km (afër ambulantes) jemi banorët më të vjetër të "Matiqanit", diku 150 vjet. Tokat tona që i kemi pas janë kanë kah rruga" B", krejt janë shitur, dhe atje sa kam kuptuar është lejuar ndërtimi i lartë, pse neve këndeje nuk po na lejohet, edhe ne duhet me pas diçka në krahasim me tjerët, kemi mbet nëpër do shpija të vjetra, kisha me e lutë Kryetarin, që kur t'i bëni Hartat Zonale e planin, të na keni parasysh, ju faleminderit.

Hysen Shillova, banor i Zllatarit. Kam vetëm një pyetje çka po ndodh me Zllatarin, e fillojnë një punë e nuk e kryejnë, nuk kemi ujë, gypi është edhe nuk lidhemi, kush po e stagnon punën andej, as s'kemi autobus, nuk kemi ujë nuk kemi rrugë, asgjë edhe ne jemi banor të këtij vendi, faleminderit.

Abdullah Krasniqi, kryetar i bashkësisë lokale VII/2, kisha me u lidhë me Zllatar. Kryetar nëse ju kujtohet që keni qenë në Zllatar, e keni pa dhe keni thënë që, rruga e Zllatarit vetëm për njerëz nuk qenka, kërkesat tjera veç i tha sekretari i bashkësisë lokale, unë vetëm të përgëzoj për punën edhe vazhdo kështu.

Sherife Vrajolli, unë dëgjova shumë këtu, jam adhures i sportit, kemi shumë të rinj këtu, ju kisha lutë që të investoni në një fushë sportive, ju faleminderit.

Endrit Gashi, kamionët e kompanisë së ndërtimit "Pozhegu", e kanë dëmtuar rrugën shumë, ju kisha lutë që rruga të rregullohet dhe të shtrohet deri në Butoc.

Agim Maliqi, banor i "Mati 1", koeficienti me plan rregullativ më del që është 2.4, kështu kur ti dorëzohet dokumentet është 1.2 ose 1.6, që tri vite asnjëherë nuk me del më shumë, po dua me e ditë ku është problemi dhe kur rregullohet kjo, ju faleminderit.

Melos Morina, kam tokë këtu dhe ju keni thënë gjatë fushatës që për 9 muaj do të behët Harta zonale dhe plani rregullativ, a ka diçka, a jeni afër se prona ime është 20 ar dhe ka mbet krejt gjelbërim, a përreth është ndërtuar.

Besim Selimi, banor i "Mati 2" rruga "C" që vazhdon deri te rruga "A", jemi si në mes, ka ndërtesa deri në 12 kate, a neve nuk na lejohet ndërtimi.

Bleat Selmanaj, banor i lagjes. Kemi problem me leje të ndërtimit, jemi peng i një vendimi që është lëshuar, sepse më plan rregullativ lejohet vetëm ndërtim i mesëm, dhe po ndihemi të diskriminuar. Jam duke folur në emër të pronarëve të 5 hektar tokë aty, që shtrihen në pjesën e parë të rruga "Sokol Sopi".

Ismail Ajvazi, banor në "Mati 2". Ju kisha lutë që koeficienti 1,2 të rritet, kamë bërë kërkesë me shkrim, (të bashkëlidhur e gjeni kërkesën më shkrim, dhe petitionin), kam qenë disa herë edhe në Komunë dhe jam takuar me zyrtarët kompetent, por ende nuk ka asgjë.

Ismet Haziri, rruga "Afërdita", është afër kësaj lagjes që po ndërtohet "City Hall", dhe shtrihet tërësisht në pronën time, unë nuk e kam penguar qarkullimin e njerëzve andej, unë nuk jam i interesuar për shpronësim por për këmbim.

Halil Gashi, kërkesë, kryetarët e bashkësive lokale të rizgjidhen, që 9 vjet janë kryetarët e njëjtë.

Arbër Sadiki, drejtor. U përmend rruga "B", për vazhdimin e rrugës "B", jemi në takim me pronarët e tokave, që ajo rrugë me u lidhë deri të pjesa e xhamisë. Është marrë edhe një vendim i veçantë nga kryetari që me u shpronësuar deri në 35% të hapësirës që merret për rrugë që me pas mundësi me u zhvilluar rruga, së përndryshe me vendimin ekzistues në 20% është e pamundur me u rregulluar.

Për sa i përket koeficientit, po ju japë vetëm një statistikë që e kemi kalkuluar prej se kemi filluar me u marrë me thellësisht, nëse realizohet PZHU-ja, ekzistuese me gjithë koeficientet që i parasheh. Parashihet me i pas 54 milion metra katror banim, po të e pjesëtosh me 45 m. katror sa është mesatarja për Bashkimin Evropian, i bie që Prishtina të jetë me 1 200 000 banorë, dhe në e dimë që asnjë projektion nuk na dërgon në ato drejtime.

Për atë edhe jemi këtu që me diskutuar me juve, me i analizuar, që me bërë plane reale për zhvillimin e Prishtinës e jo me funksionuar vetëm mbi bazën e koeficientit. Për sa i përket legalizimit, mundeni me ardhur çdo të marte dhe të enjte në Komunë me i diskutuar, edhe pse në rastin konkret kisha dashtë me ju përgjigj që nuk është në kompetencë të Komunës. Për fat të keq kur është bërë ligji për legalizim i parasheh vetëm 2 lloje të funksioneve që është afarizëm dhe banim, jemi dukë punuar në këtë drejtim që edhe këto nënkategori me u futë në kadastrë se edhe ato janë pjesë e pronës.

Problemi i "Arkosit", situata aty ku pjesë të rrugës të cilat nuk kanë mundur me u bartë të koeficienti i ndërtimit për shkak të 20% që është si kufizues, rruga ka mbetur edhe e pa shpronësuar dhe e parealizuar si koeficient. Ne jemi duke punuar së bashku me Drejtorinë e Pronës, që me i shpronësuar këto pjesë të rrugës.

Mundësitë e shpronësimit janë dy, ose duke i vlerësuar dhe paguar ose duke ia dhënë mundësinë me ndërtuar diku tjetër. U fol edhe për autobusët, ne jemi në hartim të një plani të mobilitetit bashkë me Bankën Botërore, që kjo zgjidhje me u bërë në tërësi në krejt Prishtinën, e jo pjesë pjesë, për një rezultat më të mirë. Për sa i përket mospërputhjes së koeficienteve mes PZHU-së, dhe planit rregullativ, i kemi të përditshme këto probleme, pikërisht për atë po duam me i pasur Hartat zonale, që kishin me i rregulluar këto parregullsi.

Përparim Rama, kryetar. Ju faleminderit të gjithëve që keni ardhur që së bashku mendojmë për me e ndërtuar të ardhmen e kryeqytetit. Prej aspektit profesional unë mendojë që ne duhet me e zhvilluar dhe ndërtuar Prishtinën, duke krijuar vlerë shoqërore. Vlerë shoqërore është hapësira ku ne jetojmë, duhet me na mundësuar kushtet e mira për jetesë, duke filluar nga ambienti ku jetojmë deri të hapësira që na rrethon, çerdhja shkolla, rrugët, parqet, qendrat e mjekësisë familjare, qendrat rekreative, qendrat për të moshuar, të gjitha këto.

Nëse e marrim vetëm koeficientin si parametër nuk na dërgon askund, janë bërë gabime gjatë zhvillimit të Prishtinës p.sh rruga "B", është një pjesë ku është e ngarkuar dhe tani njerëzit duan me ikë prej aty për shkak të pamundësive për me e bërë një jetë të mirë, nuk i plotëson kushtet bazike për jetesë.

Në zonën këtu të "Mati", ende kemi mundësi për zhvillim, për me krijuar një hapësirë të mirëfilltë me vlera shoqërore. Koeficienti ta jep metrin katror, por nuk ta jep vlerën. Metrit katror i rritet vlera në relacion me kontekstin, në relacion me shërbimet që ofron ai vend. Në momentin që ne e zhvillojmë këtë pjesë, e bëjmë vend të banueshëm me vlera, këto janë elementet kyçe, parametrat që ne jemi duke i marrë parasysh që ne tani e tutje të krijojmë vlerë e jo vetëm metra katror.

E kur krijojmë vlerë, ai metër katror bënë shumë më shtrenjtë se diku ku koeficienti është 2.4 p.sh, vlera e mund koeficientin. E përmendi edhe drejtori më herët, që ka shumë metër katror sa që planifikohet për 1.2 milion banorë. Mundë të e marrim shembull Detroitin në Amerikë, ka vdek qyteti, d.m.th. vdes qyteti dhe mundësia inventive, se e ki koeficientin, por nuk ke ekonomi, nuk ka vlerë.

Kemi edhe plot shembuj të tjerë që janë planifikuar apo dizajnuar në atë mënyrë që nuk janë plotësuar kushtet dhe kanë ikur njerëzit. Për këtë arsye po them që jemi për koeficient aty ku ka sens ai koeficient, mirëpo së pari jemi për vlera shoqërore për me e krijuar një jetesë më të mirë për të gjithë ne. Kur e krijojmë dendësinë duhet të krijojmë edhe vlerat, çerdhen, shkollën dhe parqet, fushat sportive, qendrën e mjekësisë familjare e shumë e shume nevoja tjera për një kualitet të mirëfillte te jetesës.

Nëse ju e shihni vetëm koeficientin i kemi diku rreth 15.000 apartamente, si blen askush. Ne duhet me qenë shumë të vetëdijshëm që të punojmë së bashku për krijimin e një vlere, të një balancimi të mirëfilltë ku Prishtina të vazhdoj të bëhet një kryeqytet që i josh njerëzit me qëndruar brenda e jo me ik. Takimi ynë sot është me ju dëgjuar juve, me i marr te gjitha pikat edhe ne, me ekipet profesionale me filluar me propozime, dhe prapë me i rishikuar me juve. Ideja është që në këtë proces askush mos me humbë por me fituar dhe mundemi me e bërë.

Banor, i lagjes përmend plani zhvillimor, dhe plani rregullues. Ju e dini që krejt planet që i ka Komuna e Prishtinës janë bërë me fontanë dëshirash, e ke “Prishtinën e re” dhe “Mati 2”, ku absurdi me i madh është që të gjitha zonat publike janë ndërtuar me 15 kate, kurse pronat private janë shndërruar në gjelbërim, ku është drejtësia këtu.

Mua ma keni pamundësuar me materializuar atë pronë me vite të tëra, nuk kam qasje fare në të, një pjesë e keni shndërruar në gjelbërim, një pjesë ndërtim të ulët. Ju e dini që “Mati 2”, që sa vite është i bllokuar dhe askush nuk dinë më të dhënë përgjigje, unë i kam tri kërkesa për kushte ndërtimore, dhe të tri kërkesat prej departamentit të juaj i kam të ndryshme.

1) Së pari për kufi, a është kufiri me prockën që është lum, a është me rrugën që është në punë, 2) në këtë fazë ju keni parapa me tërheq lumin e me vendos për rreth rrugës “A”, nuk e di a e keni analizuar, a studiuar,

3) e ke rastin e “Kodrinës”, një rrugë e keqe e ndan “Matin 1” me “Matin 2”, ku koeficienti është 1.2, ndërsa “Kodrina”, jo që e ka 3, po ndoshta edhe 4, edhe me çfarë logjike tokat tona me u marrë me u lënë mbi 70-80% parqe, e ai zotëria e ka materializuar, krejt e ata banorë kanë me e shfrytëzuar këtë gjelbërim. Këto gjera unë mendoj që janë të padrejta, dhe të papranueshme.

Mimoza Sylejmani, drejtore. Në të gjithë e dimë, edhe ju si pronar të tokave se ka dallim midis Planit Rregullues dhe Planit Zhvillimor Komunal, prandaj sipas ligjit të planifikimit bëhet Plan Zhvillimor Komunal dhe Harta zonale. Harta zonale nuk ka me pas kufij, d.m.th. të trajtohet në tërësi krejt Komuna e Prishtinës, pa dallim do të bëhet ndërlidhja e zonës urbane me rurale. Nuk do të këtë plane rregulluese të lagjeve, do të kemi vetëm plane rregulluese të hollësishme për raste specifike.

Përparim Rama, kryetar. pikërisht për arsye që ekzistojnë dhe ka pas probleme të tilla dhe vazhdojmë me pas, pajtohem me juve plotësisht që nuk është ferr që toka juaj private me u bërë park publik, ndërsa zonat tjera me u ndërtuar, e ceka edhe më herët që në aspektin e shpronësimit apo shkëmbimit trajtohen njësoj. A sa i përket koeficientit pse diku 1.2 e diku 2.4 ishte dashtë me pas një analizë të mirëfilltë për gjithë zonën që me pas arsyetim pse është vendosur ashtu. Më herët ju thashë që në këtë proces nuk do të dëmtohet askush, edhe gjatë këtij procesi mundet me filluar negociimi me Komunën.

Donjeta Sahatçiu, nënkryetare. Përshëndetje të gjithëve, faleminderit për pjesëmarrjen, do ta marrim parasysh propozimin që takimet t’i bëjmë prej orës 17 tash e tutje, faleminderit shumë zonjës, përfaqësueses së Këshillit të prindërve të shkollës “Iliria”, bashkëndjejë me to .

Kam pasur takim me herët edhe vizitë në shkollë, dua me ju informuar që jemi të njoftuar, edhe Drejtoria e Arsimit për planin që ka qenë, veç i kemi nisur procedurat për renovimin e shkollës. Sa i përket pjesës së ndriçimit, mungesës së sinjalizimit rreth shkollës janë dy kontrata të cilat kanë qenë të bllokuara nën Organin Shqyrtues të Prokurimit, për shkak të bllokimit, ne nuk kemi pasur mundësi me vazhduar me kontraktor të tjerë.

Ne i kemi nisur kontratat e reja tash dhe brenda 2-3 javëve mirëpresim që nuk ka ankesa, dhe do te vazhdojmë me nënshkrimin e kontratave në mënyrë që të nisim punën në sinjalizim dhe ndriçim. Dikush e përmendi edhe tensionin e lartë në lagjen e juaj, kjo nuk është në kompetencë të Komunës, por çka është përgjegjësi e jona është që fjalët dhe kërkesat e juaja me i bart të institucionet përgjegjëse, ne

mundemi me e bërë një kërkesë dhe ankesë të KEDS-i, që është përgjegjës për atë, që me e trajtuar sa më shpejt problemin.

Në lidhje me rrethimin e shkollës, nuk e di a e keni parë të rruga "Tirana", përgjatë hekurudhës janë vendosur disa rrethoja (mburoja), të tilla kemi në kontratë, mundemi me i shfrytëzuar me i vendos rreth e rreth shkollës, që përkohësisht me e ndaluar parkimin dhe uzurpimin e trotuareve që janë rreth shkollës "Iliria".

Veç kemi filluar me i trajtuar hapësirat përreth shkollave, e kemi nis me e trajtuar si koncept të shkolla "Elena Gjika", ku mbyllet komplet qarkullimi i veturave pranë shkollës në dy rrugë, të njëjtin koncept jemi duke filluar me e trajtuar edhe të shkollat e tjera. Jemi duke e analizuar, i kemi personat në teren që po merren me këtë punë. Gjithashtu jam shumë e lumtur me e përmend që në këtë diskutim publik ka edhe shumë gra pjesëmarrëse, dhe kisha deshtë që me vazhduar me i ftuar edhe të tjera gra që me marr pjesë në këto takime, ju faleminderit.

Përparim Rama, kryetar. Dua me e përmend edhe për bashkësitë lokale. Bashkësitë lokale janë jetike dhe me rëndësi shumë të madhe për qytetarët, se nëpërmes bashkësisë lokale Komuna është më afër qytetarëve. Tani ne kemi marr vendim dhe zgjedhjet janë në proces, do të lajmëroheni shumë shpejt.

Ismet Haziri, unë po ju njoftoj që për rrugën e Zllatarit kanë kontribuar të gjithë fshatarët, por këtu kemi një përfaqësues të familjes Tahiri, Alija, që kanë kontribuar më së shumti dhe kur e kthen në vlerën monetare kontributin e tij, është përmbi 200 mijë euro, faleminderit Ali dhe familjes Tahiri.

Laura Katona, banore e lagjes në kompleksin "Relax 5" të rruga "B". Kemi problem me ujërat e zeza, që tre vite të cilat depërtojnë në podrum dhe në garazh. Jeta aty është bërë e padurueshme për shkak të erës. Problemi është që nuk ka drenazhe rruga ku është objekti dhe sistemi i vjetër i kanalizimit(banorja i dorëzon disa foto), foto të cilat i janë përcjellë Drejtorisë së Investimeve Kapitale.

MAT 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 09/06/2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	IGADHAMI KASTRATI		
2	ASTRIT GASHI		
3	BESNI PULO		
4	BLEART SELMANI		
5	ARTON DEROLLI		
6	AGIM MALI		
7	MOLOK MORINA		
8	DAFIJE GASHI		
9	BESIM SELIMI		
10	FATOS ALIU		
11	Alja Tahiri		
12	VISAR KRASNICAI		
13	Laura Katona		
14	VALON ZIGER		
15	Behim Pllaka		
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 09/06/2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	ISMAEL HAZIRI		
2	AVDULLA KRASNIC		
3	ISMAIL SHILLOU		
4	XHELA LUMAN		
5	Selami Latifi		
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 09/06/2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	ARTA METAJ - GOVORI		
2	JETON GOVORI		
3	Egzona Isufi		
4	SHKELF VRAJOLLI		
5	AMIR GASHI		
6	ASTAT GASHI		
7	Gjeban Sejdi		
8	Nele Gashi		
9	ELIADIN RAMDANI		
10	Visar Krashigi		
11	ARIANIT ABARU		
12	Fatmir Azemi		
13	Fatmir Bajana		
14	Jenat Bajana		
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 09/06/2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	BOJAN HASIPI		
2	Kujtim Bërshatov		
3	AGON SAGU		
4	FATON QIREZI		
5	EDIL XHEHATI		
6	Ermirë Aliqaj Rexha		
7	AMIR LUNICHA		
8	Kyren Shillova		
9	Violeta Sahizi		
10	BIDA RAJHA		
11	FLAMUR IMERI		
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 09/06/2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	Muhamed Bajrami		
2	Mirina Melin		
3	KADRUSH LATIFI		
4	Milot Makolli		
5	Fatlum Fetahu		
6	Shaban Fetahu		
7	Shemsi Rashiti		
8	Johi Joki		
9	Skënder Joki		
10	Merita Hiti		
11	MEMRA AVAZI		
12	Isa Hysni		
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			